



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština – Assembly**

**LEGJISLATURA V**  
**Sesioni vjeshtor**

**Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor**  
Mbledhja nr. 53  
Prishtinë, më 15.12.2016, në orën 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla S1

**PROCESVERBAL**

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Adem Salihaj, Emilija Rexhepi, Shaip Muja, Time Kadrijaj, Murat Hoxha, Haxhi Shala dhe Salih Salihu.

Mungoi: Sergjan Popoviq.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi, **Duda Balje**, kryetare e Komisionit.

**Në këtë mbledhje u propozua ky**

**Rend i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 21.11.2016;
3. Shqyrtimi i fidaneve të sëmura dhe të importuara nga jashtë;
4. Kërkesa për rritjen e buxhetit të ARRU- së,
5. Të ndryshme.

Kryesuesja **Duda Balje**, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të përcaktuar të ditës.

## 1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës për këtë mbledhje u miratua, por kryetarja propozoi shtesë për shkak se çështja e Hades ende nuk ka përfunduar, si dhe për projektligjin për zhurmën.

## 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 21.11.2016

Procesverbali, i mbledhjes së mbajtur më 21.11.2016, u miratua pa vërejtje.

## 3. Shqyrtimi i fidaneve të sëmura të mjedrës

**Duda Balje, kryetare**, e njoftoi Komisionin rreth kësaj pike se kryeshefi i AUV- së ka njoftuar që nesër do të dërgohen përgjegjet, ndaj edhe **Adem Salihaj**, si inicues i kësaj çështjeje u pajtua që së pari të shqyrtohen ato, pastaj Komisioni të marrë qëndrim në mbledhjet e radhës, ngase duhet të dorëzohet dosja complete nga AUV- ja.

## 4. Kërkesa e ARRU- së rreth buxhetit

Kryetarja ia dha fjalën drejtorit **Raif Preteni**, i cili hollësisht e njoftoi Komisionin për shumën e kërkuar për shtesë për shkak të dy pozitave dhe njoftoi se kjo kërkesë është dërguar në ministrinë kompetente MFE dhe Komisionit Parlamentar për Buxhet.

**Adem Salihaj** potencoi faktin se diku duhet të hiqet për të shtuar këtu ku kërkohet nga ARRU- ja, prandaj nuk është lehtë dhe kërkesa është pak e vonuar.

**Haxhi Shala** megjithatë ishte për shqyrtim ngase nuk është bërë ende leximi parë i buxhetit, gjithashtu edhe Komisioni premtoi se do të shikohet mundësia në mes dy leximeve të hartohet amendamenti që kërkohet. Ndërkaq lidhur me **kërkesën nga SHUKOS-** i për ndryshimin e një Neni te Ligji për shërbimin e ujërave drejtori tha se ka kërkuar të hartohet një analizë nga kompania në fjalë dhe arsyetimi pastaj të dërgohet këtij Komisioni se a ka nevojë të hartohet një ndryshim që kërkohet. Ai potencoi vizitën që bëri Komisioni në Bullgari dhe në të gjitha vendet e rajonit e më gjerë se askund nuk ka dispozitë ligjore me të cilin dikush lirohet nga pagesa e ujit. Komisioni ishte i mendimit që kjo çështje të shqyrtohet vitin e ardhshëm dhe e **autorizoi** drejtorin e ARRU- së të kryej analizën e filluar me kompanitë e ujërave me rekomandimin adekuat.

## 5. Projektligji për zhurmën

**Kryetarja** i njoftoi se Komisioni i Përhershëm për Integritet Evropian nuk pajtohet me një amendament të këtij Komisioni rreth projektligjit për zhurmën e cila ka të bëjë me shifra të përcaktuara.

**Adem Salihaj**, si inicues i këtij amendamenti, tha se Kosova nuk ka shifra të tilla sa i përket trenave apo mjeteve të tjera transportuese, ndaj po të miratohet nuk ka kuptim as vetë ligji, megjithatë kryetarja dhe komisioni sugjeruan edhe një herë konsultime me këtë Komision.

## 6.Çështja e Hades

**Kryetarja** fillimisht arsyetoi shkakun pse ka propozuar këtë pikë e cila është stërzgjatur dhe ka mbetur ende pa ndonjë rezultat konkret. Ajo propozoi debatin rreth çështjes a duhet për këtë çështje Ligj apo rekomandim për mbledhje plenare.

Përfaqësuesja e banorëve të Hades, **Dajana Berisha**, përkundër falënderimit për iniciimet nga ky Komision, përsëriti kërkesën e dërguar dje që banorët kërkojnë vetëm zhvendosje ngase kështu me biseda nuk shihet fundi. Shumë analiza tregojnë dhe subjektet janë unik që në këtë fshat ka vetëm dëme dhe asgjë pozitive, vazhdoi, ndaj nga banorët nuk kërkohet asnjë rezolutë apo diç të tillë, por siç shihet atyre ju mbetet vetëm rruga. Duhet të detyrohen edhe Banka Botërore edhe Qeveria të ulën në tavolinë për zgjedhje adekuate, përfundoi ajo.

**Adem Salihaj** plotësisht arsyetoi kërkesat e banorëve duke pyetur se a janë për ligj apo rezolutë? Ai sugjeroi ligjin edhe pse vështirë do të realizohet sepse duhen 120 milionë, por duhet të kërkohet kontributi edhe i Bankës Botërore.

**Shaip Muja** gjithashtu arsyetoi banorët dhe kritikoi joseriozitetin institucional, sepse trojet janë të gatshme, kurse Banka Botërore dhe Qeveria po bëjnë shaka, sidomos shtoi se duhet të shfrytëzohet Ligji sapo i hyrë në fuqi për Obiliqin i cili përfshinë brengat që shfaqen këtu. Reagimi nga të pranishmit, banorë të Hades, ishte se ky ligj rregullon çështjen mjedisore, por jo zhvendosjen. Me bërë ligj duhet të kalojnë edhe tre vjet, kjo është shaka, tha dhe propozoi Rezolutë obliguese për Qeverinë për zhvendosje dhe ky proces të përfundojë më 2018. Ai sugjeroi banorët të bashkëpunojnë me kryetarin e Obiliqit, ashtu si potencohet edhe nga ligji i miratuar, citoi Nenin 6 të Obiliqit, dhe potencoi ndryshimin që ka kërkuar për Nenin 18 të Ligjit për miniera e minerale, ku gjithashtu këta banorë do të gjejnë rezultatin e kërkuar.

**Time Kadrijaj** gjithashtu sugjeroi seriozitet të madh sidomos nga Qeveria, kurse Komisioni të mundohet për një zgjidhje si të bëjë presion Qeverisë, por gjithsesi hapi parë të jetë Rezoluta.

**Murat Hoxha** ishte i mendimit se asgjë nuk bënë punë nëse nuk ka propozime konkrete për me gjetur një zgjedhje nga çdo aktor pjesëmarrës. Madje ai pjesëmarrjen e banorëve në këtë mbledhje e cilësoi si një lloj proteste, në fund sugjeroi rekomandime urgjente, të cilat po që se nuk zbatohen atëherë vjen në shprehje përgjegjësia e kërkuar.

**Salih Salihu** konstatoi se kjo Qeveri nuk qanë kokën për hallet të asnjë qytetari, ndaj pyeti banorët si të veprohet bashkë me këtë Komision, çka propozojnë?

**Haxhi Shala** tha se kjo është shaka me popull, 100 milionë nuk janë asgjë për një Qeveri por siç u tha kjo Qeveri nuk mërzhitet për askënd, vetëm për vete.

Përfaqësuesja e Avokatit të Popullit potencoi kërkesën nga takimet e mëparshme se vetëm ligji e rregullon këtë problematikë, por edhe ajo e shpronësimeve i cili është në draftim e sipër me një nen të posaçëm për zhvendosje në përgjithësi, jo vetëm për Hade, ngase ligji nuk definon asgjë vetëm për një rast konkret.

Banori i Hades, **Ragip Grajçevci**, edhe një herë rikujtoi Komisionin se pas vizitës së deputetit Agim Kuleta vetëm ky Komision ka shprehur interesimin për çështjen e tyre. Mirëpo kërkohet edhe përgjegjësi, shtoi, jo vetëm interesim, çdo herë presim muajin mars dhe si duket problemi i Hades i takon planetit mars, ai kërkoi dislokim të menjëhershëm ngase ky shtet ose nuk po din, ose s'po donë dhe për këtë arsye viti 2017 do të jetë vit i

demonstratave dhe do të bllokohet qymyri. Ai potencoi personin Hamit Leci në KEK i cili është i gatshëm sot t'i alokoi 60 milionë për këtë çështje, por Qeveria nuk ka interesim. Pas përsëritjes së kërkesave fillestare nga kryetarja se është për ligj **Emilija Rexhepi** ju drejtua se ajo nuk mund të flasë në emër dikujt dhe shtoi se duhet veç e veç të potencohen faktet relevante. Në vazhdim disa banorë potencuan problemet e tyre kryesisht duke potencuar se shteti asgjë nuk bënë rreth halleve të tyre. Pas përsëritjes së pyetjes nga **Salih Salihu** se çka dëshirojnë këta banorë, përfaqësuesja **Dajana Berisha** potencoi si vijon:

1. Të caktohet mbledhja plenare me një pikë për Haden,
2. Dy ministra (nga MMPH dhe MZHE) të raportojnë para Kuvendit,
3. Të caktohet data e zhvendosjes dhe
4. Të hartohet Ligji për shpronësime me fokus për zhvendosje

**Pasi që Komisioni sqaroi se kjo që kërkohet nga banorët është më së lehti për deputetët, banorët ritheksuan se pas një kohe të shkurtë do të njoftojnë Komisionin me kërkesat e tyre.**

## **7.Të ndryshme**

**Kryesuesja** caktoi mbledhjen e radhës me sugjerimin e anëtarëve të Komisionit për ditën e enjte kur do të ftohen dy ministrat e fushës të raportojnë rreth buxhetit dhe për murin në Mitrovicë, kurse së shpejti do të ftohet në Komision edhe përfaqësuesi i Këshillit Ndërmintoror për çështjen e ujërave në Kosovë.

Mbledhja përfundoi në orën 13:05.

**E përgatiti:**

Kryetarja e Komisionit,

**Duda Balje**

**Stafi Mbështetës i Komisionit.**